



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Председник Општине  
Belediye Başkanı

01 Nr. 232/26 Dt. 22.05.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e realizimit të projektit: “Krijimi dhe funksionalizimi i Pistës së MotoCross-it në Prizren”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit-mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Arkivës së Kryetarit.